



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 05 prill 2019, në mbledhjen e X-të (dhjetë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10;05.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Valbona Kadriu Podvorica, Zëvendës kryesuese e Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, Bashkim Sylja, Mefail Rama ndërsa munguan , Albina Avdiu dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Nexhmedin Feta nga Policia Kufitare, Fadil Babatinca nga Stacioni Policor në Podujevë, Veton Vehapi përfaqësues i OSBE-së, dhe dy përfaqësues të KFOR - LMT.

Miratimi i rendit të ditës

znj.Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i njoftuar rreth pikave të rendit të dhe shtoi, nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 06.03.2019

Njëzëri u miratua

2. Paraqitja e Informatës nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale rreth gjendjes sociale – ekonomike të Komuniteteve RAE me theks të veçantë gjendjes së banimit

znj.Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës kemi ftuar zyrtarin përkatës nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, i cili do të paraqet informatën përkatëse.

z.Zenel Zeneli, shef i sektorit për mirëqenie sociale, në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, për këtë mbledhje si pikë keni paraparë informatë rreth gjendjes sociale ekonomike të Komunitetit RAE, edhe pse nuk është specifikuar periudha, mendoj se bëhet fjalë për vitin 2018. Si DSHMS bazohet në dy fushëveprime të ndihmave, nga të hyrat

vetanake dhe nga donatorët. Komuniteti RAE gjatë vitit 2018 nga të hyrat vetanake janë ndihmuar 7 familje me shumë të përgjithshme 700.00€, kurse në bashkëpunim me donator janë ndihmuar dy familje me lëndë djegëse (dru për ngrohje), si dhe 69 familje janë ndihmuar me gjëra ushqimore dhe higjienike. DSHMS vepron vetëm në bazë të kërkesave, ku palët paraqesin kërkesa, është komisioni përkatës i cili del në terren konstaton gjendjen dhe varësisht prej mjeteve që kemi ndihmon ato familje.

Sa i përket çështjes së banimit ne vazhdimisht kemi kërkesa për banim nga ana e Komunitetit në fjalë, mirëpo siç jeni në dijeni, në 5 vitet e fundit Komuna nuk ka ndarë mjete buxhetore për ndërtimin e shtëpive. Në bazë të kërkesave të familjeve, ne kemi dal në terren dhe kemi vizituar ato familje dhe kemi të gjitha të dhënat, por në mungesë të mjeteve buxhetore nuk kemi pas mundësi të ndihmojmë asnjë familje, fjala është për ndërtim të shtëpive. Në bazë të asaj që kemi hasë gjatë vizitave, disa familje të Komunitetit në fjalë vërtetë jetojnë në kushte të vështira qoftë ekonomike qoftë të banimit ku ka të atilla që janë me numër të madh të anëtarëve të familjes, pastaj te një numër i atyre familjeve ekziston edhe një papastërti që do të thotë me kushte higjienike jo të mira për shkak se numri i madh i anëtarëve të familjes dhe hapësirat jo të mjaftueshme për banim e bëjnë një gjendje të tillë, mirëpo në bazë të një projekti të një numri të Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Grupit 6 plus, dy familje të Komunitetit RAE janë propozuar-përzgjedh nga Komuna e Podujevës për ndërtimin e shtëpive për atë familje, procedurat rreth dokumentacionit janë përfunduar dhe ka mbete vetëm fillimi i ndërtimit të shtëpive. Pra kjo ishte informata përkatëse në pika të shkurtra për vitin 2018.

z.Bashkim Sylja, theksoi, dëshiroj të ndërlihem me atë që zyrtari parafolës e potencoj, përkatësisht për ndihmën që është bërë për 7 familje me një shumë prej 700.00€ nga të hyrat vetanake, po ta marrim në përgjithësi bëhet fjalë nga 100€ për secilën familje, pastaj dy familje janë ndihmuar me lëndë djegëse prej donatorëve, mandej ishin edhe 69 familje që janë ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike sërish prej donatorëve, mirëpo më intereson se sa ka qenë shuma e atyre pakove ushqimore dhe higjienike për ato 69 familje, sa është shuma e një pakoje të tillë.

z.Zenel Zeneli, përgjigje parafolësit, kryesisht shuma për një pako të tillë arrin shumë prej 30€ deri në 50€, varësisht prej donatorëve, me vete nuk i kam të dhënat e specifikuara, por nëse kërkon mund t'i marrë dhe t'jua prezantoj secilën.

z.Bashkim Sylja, pyetje, kërkesat për ndihmë financiare për raste sociale shëndetësore, a përfshihen në planifikimet buxhetore të DSHMS-së, si dhe a parashihet numri i familjeve që do të ndihmohen, jo vetëm të Komuniteteve jo shumicë por në përgjithësi, pastaj atyre që janë në asistencë sociale. Pra a janë të parapara këto që i ceka në buxhetin e vitit 2019 dhe a keni përkrahje nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave për kërkesat në fjalë.

z.Zenel Zeneli, përgjigje parafolësit, përjashtimi nga donatorët, në DSHMS zakonisht për çdo vit, qe pesë vitet e fundit, ndahen rreth 50,000.00€ për subvencione, dhe varësisht prej numrit të atyre që paraqesin kërkesa për ndihmë që janë asistencë sociale apo raste sociale, për çdo muaj shuma që ndahet është rreth 1,000.00€ - 1,500.00€. Pastaj është një numër rreth 200-300 familje që nuk gëzojnë asistencë sociale sepse nuk mund t'i përmbushin kushtet dhe kriteret që kërkohen nga Qendra për Punës Sociale – QPS, e që në fakt janë raste sociale por pa dokumente, dhe sipas asaj që ne i shohim në terren janë raste edhe më të rënda sesa ato që janë në asistencë sociale. Mandej qe 5 vite radhazi ndihmohet Handikos me shumë vjetore rreth 15,000.00€, nga buxheti prej 50,000.00€ që i kemi si DSHMS për subvencione.

z.Bashkim Sylja, theksoi, në fillim të muajit janar ne si Kuvend kemi miratuar një vendim me të cilin Handikos është ndihmuar me 14,500.00€. Sa i përket rasteve që kanë nevojë, ju ndoshta jeni

punëtorë të Komunës dhe keni më shumë përvojë, mirëpo mendoj se shqetësimet dhe kërkesat tona duhet ti merrni parasysh dhe ti adresoni në Drejtori, andaj ky buxhet duhet të rritet.

z.Zenel Zeneli, theksoi, ne si Komunë e kemi një Rregullore e cila përcakton mënyrën e ndarjes së subvencioneve, themelohet një komision i cili merret me shqyrtimin e kërkesave dhe rekomandon. Shuma apo dhënia e subvencionet janë të limituara, komisioni mund të ndihmoj me subvencion një familje deri në 300.00€ dhe atë 1 herë në vit, dhe në këtë aspekt edhe nga Komunitetet RAE janë ndihmuar 7 familje ashtu siç e ceka në fillim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, thelbi i gjithë asaj që unë po dua të them është që të gjitha këto shqetësime dhe kërkesa tonat t'i adresoni në DSHMS në mënyrë që të hyjnë në planifikime buxhetore.

z.Zenel Zeneli, theksoi, ne si Drejtori përkatësisht si sektor për mirëqenie sociale për çdo vit e hartojmë planin e veprimit dhe po ashtu çdo fund vit hartojmë raportin i cili dërgohet në te drejtori i DSHMS-së kurse çështjet tjera pastaj janë çështje Drejtorisë me strukturat tjera të Komunës.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, meqë këtu jemi përfaqësues të shumicës së subjekteve politike në Kuvendin e Komunës, ne ndoshta bashkërisht me DSHMS-në mund të kërkojmë që kur të bëhet riallokimi i buxhetit, të kërkojmë një shumë më të madhe për subvencione në mirëqenien sociale, si dhe shuma e ndarë për Handikos mos të merret nga buxheti i ndarë për subvencione në DSHMS-së, gjithashtu duhet të mundohemi dhe të kërkojmë që të bëjmë zgjidhje për ato që u ceken rreth papastërtisë dhe kushtet e rënda higjienike tek disa familje të Komunitetet jo shumicë, andaj nëse Komuna nuk mund të bënë më shumë të paktën për këto gjëra të vogla do të mund të ndante shuma buxhetore, aq më shumë kur jemi në dijeni se Komunës po i tepron buxhet. Pra do të ishte mirë që kur kemi të bëjmë me riallokimin e buxhetit, të mbajmë një mbledhje dhe të kërkojmë nga ky Komitet që një pjesë e mjeteve buxhetore të dedikohet për subvencione për raste sociale dhe raste të rënda ekonomike.

z.Zenel Zeneli, theksoi, kjo që u tha nga parafolësja do të ishte e mirëseardhur për ne si sektor i mirëqenies sociale sepse do të hapeshin më shumë mundësi për t'i ndihmuar raste të tilla, qoftë edhe me shuma më të mëdha. Vetëm muajin e kaluar kemi pas rreth 100 kërkesa për ndihmë – subvencionim, janë refuzuar 11 kërkesa, kurse të tjerat është dashtë t'i miratojmë respektivisht t'i ndihmojmë ato familje apo persona me gjendje të rëndë qoftë sociale, ekonomike, shëndetësore, ku shuma e përgjithshme ka qenë 9,800.00€, ndërsa në këtë muaj kemi edhe rreth 70 kërkesa të tilla, dhe nëse i miratojmë edhe këto ne për gjashtëmujorin e dytë të vitit nuk do të kemi asnjë shumë buxhetore për raste të tilla. Pra kjo është gjendja reale, megjithatë ne jemi në monitorim të gjendjes dhe ndihmojmë familje dhe persona të ndryshëm me shuma nga 50 € deri në 300 €, varësisht si e vlerëson komisioni.

z.Mefail Rama, pyetje për parafolësin, u tha se janë përzgjedh dy familje nga Komunitetet RAE për ndërtimin e dy shtëpive, andaj pyes a ka buxhet të mjaftueshëm për ndërtimin dhe përfundimin e atyre dy shtëpive.

z.Zenel Zeneli, përgjigje parafolësit, projekti në fjalë duke përfshirë edhe buxhetin e ndarë është nga qendra përkatësisht nga Deputetët e Grupit 6+ të cilët kanë një program të veçantë për raste të tilla të Komuniteteve jo shumicë.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK, theksoi, sa për sqarim, çështja që ka të bëjë me ndërtimin e dy shtëpive për dy familje të Komuniteteve jo shumicë, ka qenë edhe në raportin e punës së ZKKK-së i cili është shqyrtuar në muajin e kaluar. Fjala është për familjen e Alush Bahtirit dhe familjen e Rukie Miftarit. Ka qenë kërkesë dhe është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, iniciativë kjo e cila ka qenë e Deputetëve të cilët përfaqësojnë Komunitetin jo shumicë, procedurat dhe dokumentacioni pronësor për këto dy familje janë kryer dhe tani varet prej buxhetit dhe

organeve përkatëse të nivelit qendrorë se kur ata janë në gjendje t'i ndihmojnë përkatësisht të fillojnë me ndërtimin e atyre dy shtëpive për dy familjet cekura.

z.Bashkim Syla, theksoi, lidhur me atë që parafolësja znj.Dornuntina Hasani e ceku për rialokimin e mjeteve. Rialokimi i mjeteve nga të hyrat vetanake është kryer në mbledhjen e kaluar, procedurë kjo e cila fillimisht rialokimi propozohet nga Ekzekutivi, shkojnë në KPF ku miratohen dhe pastaj sjellën në Kuvendin e Komunës për miratim final. Pra për vitin 2019 kjo çështje ka përfunduar dhe nuk kemi çfarë të bisedojmë, ndërsa sa i përket rishikimit të buxhetit në këtë vit, ka mundësi të bëhet një gjë e tillë, mirëpo ashtu siç e ceka edhe më herët ne mund të propozojmë dhe të insistojmë në rritjen e buxhetit për subvencione të tilla edhe me rastin e miratimit të buxhetit për vitin 2020.

z.Zenel Zeneli, theksoi, unë u mundova të paraqesë gjendjen reale si është, kurse mirëpresim çdo iniciativë të tillë për rritje të buxhetit. Ne gjithherë jemi në terren dhe monitorojmë gjendjen e familjeve me kushte të rënda sociale, ekonomike dhe shëndetësore, mirëpo për t'i plotësuar të gjitha nevojat e tyre, konsideroj se jemi shumë larg. E njëjta situatë është edhe me komunitetin shumicë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, fillimisht e falënderoj shefin e sektorit të mirëqenies sociale për informatat e dhëna e që konsideroj se janë të sakta dhe paraqesin gjendjen reale, temë kjo e cila ka të bëjë edhe me banimin/strehimin çështje me të cilën jemi mare bukur gjatë dhe ka kërkesa qoftë nga e kaluara qoftë edhe tani. Çështja e banimit është paksa problematike sepse kemi të bëjmë me strehim jo vetëm për komunitetet jo shumicë por janë kërkesa të të gjithë qytetarëve të Komunës tonë. Ndoshta më parë në vitet e kaluara ka pas me rreth 200 kërkesa për banim, dhe jemi në dijeni se në të kaluarën Komuna ka ndarë buxhet për ndërtimin e shtëpive për familjet nevoja të mëdha, por ideja ka qenë që shtëpitë t'ju ndërtohen në pronat e tyre, kjo ngase ne si Komunë nuk kemi qendër sociale të banimit sepse është një problematikë e mirëmbajtjes së qendrave të tilla, andaj kemi shkuar në atë formë që e ceka, dhe në kuadër të kësaj edhe familjet e Komuniteteve pakicë kanë qenë përfituese të ndërtimit të shtëpive mirëpo problemi më i madh ka qenë dhe vazhdon të mbetet është legalizimi i pronave sepse edhe pse ka pasë kërkesa të shumta nga komunitetet jo shumicë ka qenë problematik e pronave sepse nuk kanë pasë në posedim prona apo të themi nuk kanë mund të legalizojnë ato ekzistuese. Vlen të ceket se nga Qeveria e kaluar ka qenë një iniciativë që pronat e tilla të legalizohen, por përse ka ngecje tani është problem tjetër, dhe kjo nuk nënkupton vetëm për komunitetet jo shumicë por për të gjithë. Në qoftë se i referohemi punësimit ne po jemi në dijeni ku dhe si jetojmë, çështje kjo e cila mund të them se na ka katandisur dhe gjendemi në gjendje shumë të rëndë, temë me të cilën po merren dhe po e cekin të gjithë dhe që po na shqetëson të gjithëve ashtu siç po na shqetëson edhe ikja sidomos e të rinjve të vendit në drejtim të shteteve evropiane, gjë të cilën nuk do të mund ta imagjinonte askush një situatë të tillë e që nga kjo është prekur edhe komuniteti jo shumicë. Mund të them se kjo është çështje e ndjeshme sepse është problem paska më jetik më i madh dhe që duhet të diskutohet edhe në qarqe më të larta shtetërore, por që ndoshta nuk po gjejnë kohë të merren me këto tema. Ajo që e paraqet gjendjen reale është QPS, dhe nëse i referohemi asaj paraqitet një gjendje jo e mirë edhe e komuniteteve jo shumicë ku 68 familje të Komuniteteve jo shumicë që janë në asistencë sociale, prej tyre 66 ashkalinj me 426 anëtarë, dhe 2 familje të komunitetit rom me 15 anëtarë, pra 441 anëtarë/persona që janë të verifikuar nga komisioni i veçantë i QPS i cili del dhe verifikon në detaje dhe i përmbahet, gjendje kjo e cila na bën të kuptojmë se nuk qëndrojmë mirë. E pëlqej atë që u tha nga parafolësit që të gjithë këshilltarët e Kuvendit të kenë ndikim në Kuvendin e Komunës në kuptim të rritjes së fondit buxhetor për ndihma sociale, ekonomike, shëndetësore etj për të gjitha komunitetet por me theks të veçantë për atë jo shumicë, edhe pse elementi i ndihmës

preventive po e quaj kështu, nuk është edhe aq i mirë sepse po krijon “parazitë”, dhe në këtë që e them mendoj se duhet të jemi të sinqertë, por duke analizuar në kuptim të gjerë gjendjen ekonomike, sociale dhe shëndetësore, më mirë është të kërkohet ndihmë në institucione shtetërore se sa të shkohet me lëmosh, e që vlen të ceket, ndoshta edhe ju e keni vërejtur se shumë pak ka persona të komuniteteve jo shumicë që kërkojnë lëmosh, për Komunën e Podujevës është fjala, element ky shumë interesant dhe specifik, në kuptimin pozitiv po e them këtë. Ne e kemi obligim të ndihmojmë, por nganjëherë persona të ndryshëm po bien pre e dezinformatave të ndryshme të peronave të ndryshe, dhe në këtë kontekst më 26 shkurt të këtij viti më është paraqitur një kërkesë nga Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e që unë e kam paraparë se është problem realizimi i saj, ku mbi 30 kërkesa i kemi për kompletim të dokumentacioneve për renovim të shtëpive, çështje kjo e cila ka të bëjë me strehimin dhe që zyrtarja përkatëse i ka të gjitha të detajuara rreth kësaj çështje sepse e njëjta ka vizituar të gjitha ato familje të cilat vërtetë janë kanë nevojë edhe për renovim të shtëpive. Pra çështja e punësimit dhe ajo e strehimit janë paksa më delikate por edhe çështje sociale e cila na ka kapluar në përgjithësi, mirëpo gjithsesi ne duhet të jemi vazhdimisht në shërbim të qytetarëve dhe të punojmë me shpresë dhe për shpresë të qytetarëve.

znj.Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit, theksoi, e konsideroj të mbyllura këtë pikë të rendit të ditës,

3. Të ndryshme

Anëtarët e Komiteti diskutuan rreth vizitave të Komuniteteve dhe Komiteteve për Komunitete në Komuna të ndryshme të Kosovës të parapara me planin e punës dhe si përfundim mbetet që anëtarët e Komitetit të diskutojnë pas mbledhjes dhe të vendosin se kur do të zhvillojnë vizitat në fjalë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05’

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr. 01-016/01-0032752/19
Podujevë,
05 prill 2019

zv.Kryesuese e Komitetit
Valbona Kadriu-Podvorica